

DEKRET
Nr.7407, datë 31.7.1990

**PËR VEPRIMTARINË EKONOMIKE TË NDËRMARRJEVE ME PJESËMARRJEN E
KAPITALIT TË HUAJ NË RPS TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshilit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike ndërmarrje me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në përputhje me objektivat e përcaktuara në planet e zhvillimit aktual e perspektiv të ekonomisë së vendit.

Neni 2

Ndërmarrja me pjesëmarrje të kapitalit të huaj (me poshtë e quajtur “ndërmarrje”) është person juridik me seli në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, që krijohet në bazë të një kontrate, në të cilën njëra palë është person juridik shqiptar me seli në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe pala tjetër është person i huaj ose shqiptar, juridik ose fizik, me seli jashtë territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (më poshtë i quajtur “person i huaj”).

Neni 3

Ndërmarrja ka për qëllim:

- modernizimin e objekteve ekzistuese ose ngritjen e objekteve të reja me teknologji të përparuar, që kanë për bazë nxjerrjen dhe përpunimin e lëndëve të para të vendit;
- rritjen e eksportit ose pakësimin e importit;
- rritjen e lloshmërisë së mallrave të konsumit;
- krijimin e vendeve të reja të punës;
- futjen e metodave moderne të organiizmit e të drejtimit të prodhimit dhe të shërbimeve etj.

Neni 4

Objekti dhe veprimtaria e ndërmarrjes përcaktohen në kontratën dhe në statutin e saj.

Neni 5

Veprimtaria e ndërmarrjes, marrëdhëniet që lindin nga kontrata në bazë të së cilës ajo krijohet, si dhe marrëdhëniet e saj me personat e tjerë juridikë shqiptarë, rregullohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 6

Veprimtaria ekonomike e ndërmarrjes dhe investimet e personave të huaj në të mbrohen nga

shteti, i cili u siguron atyre kushtet ë njëjta me personat juridikë shqiptarë.

Me dispozita të Këshllit të Ministrave mund të vihen kufizime të veçanta për personat e huaj të atyre shteteve që zbatojnë kufizime të tilla ndaj veprimtarisë së personave shqiptarë.

Neni 7

Ndërmarrja ushtron veprimtarinë e saj pas marrjes së autorizimit përkatës nga organi kompetent shtetëror.

Neni 8

Ndërmarrja përgjigjet për detyrimet e saj me fondet e veta. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e shtetit dhe as për detyrimet e personave të tjerë juridikë. Shteti dhe personat e tjerë juridikë nuk përgjigjen për detyrimet e ndërmarrjes.

Neni 9

Afati i veprimtarisë së ndërmarrjes përcaktohet në kontratë.

Neni 10

Ndërmarrja, në përputhje me statutin e saj, përcakton programin pesëvjeçar dhe vjetor të veprimtarisë ekonomike e financiare.

Neni 11

Ndërmarrja, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës i paraqet organeve financiare vendase raportin e veprimtarisë së saj dhe bilancin vjetor.

KREU II AUTORIZIMI PËR LIDHJEN E KONTRATËS

Neni 12

Autorizimi për lidhjen e kontratës ose për ndryshimin e saj jepet nga Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, me kërkesën e personit juridik shqiptar, nëpërmjet Ministrisë që ka në varësi sektorin ku do ta shtrijë veprimtarinë ndërmarrja.

Në fushën e veprimtarisë bankare autorizimi jepet nga Banka e Shtetit Shqiptar.

Këshilli i Ministrave shqyrton e vendos lidhur me kërkesën për autorizim jo më vonë se 2 muaj nga data e paraqitjes së saj.

Neni 13

Kërkesa për autorizimin duhet të përmbajë:

- a) emrin e ndërmarrjes, qendrën e veprimtarisë dhe të dhënat lidhur me personat e huaj;
- b) qëllimin e veprimtarisë së ndërmarrjes;
- c) subjektet dhe format e ndërmarrjes;
- ç) studimin e plotë, ku të përfshihet edhe analiza teknike dhe ekonomike e veprimtarisë së ndërmarrjes;
- d) kapitalin bazë, aksionet e pjesëmarrësve të veçantë, formën dhe monedhën në të cilën do të bëhen pagesat, mënyrën e shpërndarjes së fitimeve dhe mbulimin e humbjeve, si dhe shumën minimale për fondin rezervë;
- dh) projektstatutin dhe projektkontratën.

Neni 14

Autorizimi lëshohet për një periudhë kohe deri në 10 vjet. Kërkesa për zgjatjen e afatit bëhet 1 vit para përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit në fuqi.

KREU III ADMINISTRIMI I NDËRMARRJES

Neni 15

Ndërmarrja e zhvillon veprimtarinë në përputhje me kontratën dhe me statutin e saj. Ajo vendos vetë, brenda territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë marrëdhënie ekonomike për kryerjen e veprimtarisë së saj, duke lidhur kontrata me ndërmarrjet vendase.

Neni 16

Ndërmarrja furnizohet me lëndë të para e me mallra të tjera në kushte konkurruese. Furnizimi materialo-teknik nga vendi ose nga improti bëhet me monedhën e caktuar në kontratë.

Neni 17

Ndërmarrja vendos vetë për formën e marrëdhënieve të saj me partnrët jashtë shtetit. Ajo mund të lidhë kontrata me ta në mënyrë të pavarur, brenda caqeve që lejon legjislacioni i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë ose bashkëpunon me ndërmarrje të tregtisë së jashtme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për kryerjen e eksporteve dhe importeve të saj.

KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR

Neni 18

Ndërmarrja përcakton fondet e mëposhtme:

- a) një fond rezervë për të mbuluar humbjet ose rreziqet dhe për të financuar luhatjet në administrimin e ndërmarrjes si në monedhën shqiptare, ashtu edhe në atë të huaj;
- b) fonde kulturore e shoqërore, si dhe fonde shpëblimi, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara nës tatut.

Neni 19

Ndërmarrja, me mbarimin e çdo viti kalendarik pas pagimit të të gjitha taksave, jo më pak se pesë për qind të fitimeve i cakton për fodnin rezervë, derisa ku të arrijë shumën e caktuar në kontratë.

Pas pagimit të taksave dhe veçimit të mjeteve monetare, spas neneit 18 të këtij dekreti, ndërmarrja mund të caktojë lirisht një fond për zhvelimin e mëtejshëm të saj ose për qëllime të tjera.

Neni 20

Fondet e caktuara nga ndërmarrja, janë të pablllokueshme. Ajo ka të drejtë t'i përdorë ato lirisht, sipas qëllimit për të cilin i ka krijuar.

Neni 21

Pas pagimit të taksave dhe caktimit të fondeve, fitimi ndahet ndërmjet pjesëmarrësve.

Neni 22

Bilanci vjetor i ndërmarrjes dhe raporti financiar vjetor miratohen sipas rregullave të përcaktuara në statutin e ndërmarrjes.

KREU V ADMINISTRIMI I VALUTËS

Neni 23

Ndërmarrja vetëfinancohet në lekë dhe në valutë të huaj.

Neni 24

Ndërmarrja hap llogari në valutë të huaj në Bankën e Shtetit Shqiptar. Një llogari e tillë mund të hapet edhe në një bankë të huaj, në marrëveshje me Bankën e Shtetit Shqiptar.

Neni 25

Personi i huaj ka të drejtë të transferojë jashtë shtetit pjeësën e tij të fitimit.

Neni 26

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me monedhë të huaj dhe e kundërta bëhet në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar.

Neni 27

Ndërmarrja ka të drejtë të marrë kredi në valutë të huaj nga Banka e Shtetit Shqiptar. Ajo mund të marrë një kredi të tillë edhe nga një bankë e huaj, në marrëveshje me Bankën e Shtetit Shqiptar.

KREU VI KUSHTET EKONOMIKE

Neni 28

Ndërmarrja krijon një sistem informacioni ekonomik, në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme për ndërmarrjet shqiptare.

Neni 29

Ndërmarrja mban llogari në monedhë shqiptare, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të zbatueshme për ndërmarrjet shqiptare. Asaj mund t'i bëhen përjashtime nga ky rregull prej Ministrisë së Financave.

Neni 30

Ndërmarrja u jep organeve përkatëse shqiptare të dhëna kontabël dhe statistikore për çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në dispozitat ligjore të zbatueshme për ndërmarrjet shqiptare.

Neni 31

Fitimet e realizuara nga ndërmarrja taksohen. Masa e taksës caktohet nga Ministria e financave.

Neni 32

Kur veprimtaria ekonomike e ndërmarrjes gjatë një viti taksues del me humbje, lejohet që taksa të merret nga fitimi i realizuar brenda tre vjetëve të ardhshëm.

Neni 33

Nuk taksohen ato pjesë të fitimit që, sipas një kontate dhurimi, i kalojnë në organizate shoqërore ose institucioni kulturor, shkencor apo arsimor shqiptar, si dhe fondet që caktohen për t'u ardhur në ndihmë viktimave nga fatkeqësitë natyrore.

Neni 34

Ndërmarrja detyrohet të mbajë kontabilitetin sipas rregullave të përcaktuara nga organet shtetërore kompetente shqiptare. Ajo jep çdo vit, me kërkesën e organeve kompetente të taksave, informacione për veprimtarinë kontabëkl dhe ekonomike të ushtraur prej saj.

Neni 35

Fitimi i vitit deklarohet brenda një muaji nga nxjerrja e bilancit vjetor, por jop më vonë se deri më 31 mars të vitit pasues taksor.

Ministria e Financave, në zbatim të nenit 31 të këtij dekreti, brenda një muaji nga paraqitja e deklaratës për fitimin e ndërmarrjes, nxjerr aktin përkatës për taksat.

Neni 36

Lëndët e para, materialet dhe pajisjet e importuara nga ndërmarrja për prodhime për eksport, nuk i nënshtrohen taksës doganore.

Nuk i nënshtrohen taksës doganore edhe materialet, makineritë e pajisjet etj, që importohen për riinvestim.

KREU VII MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 37

Marrëdhëniet e punës në ndërmarrje rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Palët në kontratën e punës mund të merren vesh që punonjësve të huaj të ndërmarrjes një pjesë e pagës t'u jepet në devizë.

Mosmarrëveshjet e punonjësve me ndërmarrjen zgjidhen nga gjykata shqiptare. Kur pala ankuese është një punonjës i huaj, mosmarrëveshja zgjidhet nga organi që përaktohet në kontratën e punës.

Për çështjet që nuk rregullohen në kontratën e punës, zbatohen dispozitë e legjislacionit shqiptar të punës.

Neni 38

Punonjësit shqiptarë të ndërmarrjes sigurohen në përputhje me legjislacionin shqiptar të sigurimeve shoqërore, kurse punonjësit e huaj sipas rregullave të përcaktuar në statut.

Neni 39

Me dispozita të veçanta mund të vendosen kushte plotësuese për pagën e punës të punonjësve shqiptarë që punojnë në këtë ndërmarrje.

Neni 40

Mbrojtja e interesave të punonjësve të ndërmarrjes garantohet me legjislacionin shqiptar.

KREU VIII
MBYLLJA E NDËRMARRJES

Neni 41

Ndërmarrja mbyllet, kur vërtetohen rastet e përcaktuara në kontratë.

Neni 42

Shpërndarja e ndërmarrjes bëhet sipas rregullave të përcaktuara në statutin e saj.

Neni 43

Ky dekret hyn nëfuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA